



926
05-06-2018



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
NJËSIA E SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË SË UST

Tiranë, më 04.06.2018

Drejtuar: **Rektorit të Universitetit të Sporteve të Tiranës**

Prof. Dr. Agron CUKA

Lënda : **Raporti i Punës për Muajin Maj i NJSBC-së pranë UST.**

R A P O R T

Gjatë muajit Maj 2018 Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë së UST (NJSBC), e përbërë nga: Prof. Dhimitraq Stratobërdha Kryetar

Dr. Mirjeta Cenaj Anëtar

Doc. Anduela Lile Anëtar

në përputhje me detyrat, që u ngarkon Ligji i Arsimit të Lartë 80/2015, udhëzimet dhe aktet e tjera nënligjore të lidhura me punën e NJSBC –ve pranë IAL (UST), bazuar në Plan Veprimin për vitin 2018 ka vazhduar punën për të marrë informacione nga njësitë kryesore, administrata e UST dhe gjetjen e referencave, si Manualin e ASCAL eksperiencat e institucioneve të tjera të arsimit të lartë, për të krijuar dokumentacionin e kësaj njësie në përputhje me ligjin e aktet e tjera nënligjore.

Kemi hyrë në fazën e dytë të vlersimeve, që është edhe më e rëndësishmja e që duhet tu përgjigjet standardeve ku do të arrijë cdo IAL.

Konkretisht bazuar në kërkesën e FVFR për akreditim të programit Msc në Menaxhim dhe momentit të përgatitjes së RVB (Raportit të Vlerësimit të Brendshëm) nga ana jonë u përgatit një pyetsor për studentët e Msc Menaxhim FVFR dhe u tërhoq mendimi i tyre për cilësinë e mësimdhënies për lëndët e programit të studimit. Ky raport iu paraqit edhe Grupit të Vlerësimit të Jashtëm të ASCAL që do bëjë RVJ për akreditimin e Programit të Menaxhimit.

Nga ana tjetër u përgatitën, iu shpërndanë studentëve dhe janë duke u mbledhur pyetsoret nga gjithë programet e UST deri në fillimin e sezonit provimeve.

Ky raport është përgatitur sipas pikes 5 të Vendimit nr. 9 më datë 02.03. 2018 të Bordit të Administrimit të UST, në mënyrë që të kryhet pagesa mujore për të tre anëtarët e NJSBC.

Kryetari I NJSBC

Prof. Dr. Dhimitraq STRATOBËRDHA